



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:255405

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874574

KPPP.nr.1957/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit “Trema Engineering 2” SH.P.K., me NUI:810488826, me seli në Prishtinë, rruga “Ahmet Krasniqi”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Gafurr Elshani dhe Sahit Bibaj, që të dy avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Prishtina City Center” SH.A., me NUI:810519019, me seli në Prishtinë, rruga “Robert Doll”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Atdhe Dika, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.610/23 të datës 03.11.2023, të Përbaruesit Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Prishtina City Center” SH.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.610/23 të datës 03.11.2023, të Përbaruesit Privat Rezarta Metaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor P.nr.610/23 i datës 03.11.2023, i lejuar nga Përbaruesit Privat Rezarta Metaj.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 422.50 € (katërqind e njëzet e dy euro e pesëdhjetë cent) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Trema Engineering 2” SH.P.K., në bazë të titullit ekzekutiv Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.495/2019 të datës 14.12.2021, dhe Aktgjykimit

të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr.1351/2022 të datës 12.07.2023, ka nxjerr urdhrin përmbarimor P.nr.610/23 të datës 03.11.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit kryesor për punët e kryera t'ia paguaj kreditorit shumën prej 521,456.06 €, me kamat ligjore 8% në vit nga data 02.09.2019 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 4,660.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore. Përmbushja e detyrimeve të debitorit ndaj kreditorit të bëhet me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e të hollave në llogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar propozimin për përmbarim si të pabazuar, duke shtuar se lidhur me prapësimin e debitorit gjykata do të duhej të vendos pas pranimin të vendimit lidhur me revizionin e ushtruar nga ana e debitorit. Tutje ka shtuar se kreditori është regjistruar si shoqëri tregtare vetëm për qëllimin e kryerjes së shërbimit dhe punëve në objektin ndërtimor në të cilin investitor është debitori, për me tepër kapitali themeltari i kreditorit është vetëm 3,000.00 €, shumë kjo e cila në një rast të kundër përmbarimit nuk do të mund të mbulonte as shpenzimet e procedurës. Për me tepër ka shtuar se autorizimi i dhënë nga z. I.T. për iniciimin e kësaj procedure përmbarimore nuk është i dhënë nga personi zyrtar i kreditorit, andaj në këtë rast janë plotësuar kushtet nga neni 71 i LPP-së. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj në tërësi prapësimin e debitorit, ta anuloj urdhrin përmbarimor si dhe ta refuzoj propozimin për përmbarim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar prapësimin si të pabazuar, duke theksuar se revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë, nga ana e debitorit është kërkuar që aktgjykimi të përmbushet në mënyrë vullnetare por i njëjti nuk e ka përmbushur andaj përmbushja është kërkuar me propozimin për përmbarim. Tutje ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e ngritura sa i përket autorizimit pasi që kreditori ka pasur ndërrim të menaxhmentit andaj ka bashkangjitur edhe autorizimin nga menaxhmenti i ri i kreditorit për ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore deri në përfundim të kësaj procedure. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi, si dhe të detyrohet debitori që kreditorit t'ia kompensoj shpenzimet e përgjigjes në prapësim në shumën prej 422.50 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që

gjenden në shkresat e lëndës dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.495/19 të datës 14.12.2021, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1351/22 të datës 12.07.2023, në bazë të së cilëve përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti se të njëjtit sipas nenit 22 paragrafit 1 nën paragrafi 1.1 të LPP-së, janë përcaktuar si dokumente përmbartuese sipas të cilëve mund të caktohet përmbartimi. Gjykata gjeti se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.495/19 i datës 14.12.2021, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1351/22 i datës 12.07.2023, i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pasi që të njëjtit përmbajnë të dhënat për kreditorin dhe debitorin, objektin e detyrimit të debitorit dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.495/19 i datës 14.12.2021, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1351/22 i datës 12.07.2023, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbartueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”,* ngase Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.495/19 i datës 14.12.2021, i vërtetuar

me Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1351/22 i datës 12.07.2023, është bërë i plotfuqishëm me datë 10.10.2023 dhe të ekzekutueshëm nga data 25.10.2023.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, duke i'a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë shumën 422.50 € (katërqind e njëzet e dy euro e pesëdhjetë cent), siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifatat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08 L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1957/23, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.